

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1


Botërori 2026 'rrëzon' një tjetër trajner, Roberto Martinez largohet nga Portugal! Kush pritet ta zëvendësojë
- 2

Mesazhet / 'Njerëzit janë mërziur, t'a rifillojmë protestën në tetor, Diaspora vjen për Dhërmiun, të sabotojmë koncertin e Kanye West', 'flamingot' të dëshpëruar, deklarojnë fundin e revolucionit
- 3

Trump këmbëngul për Kupën e Botës: Po, telefonova Infantino! Kritikat ndaj arbitrit, gjurmët e fshirja! Tani Franca dhe Anglia duan t'u hiqen dy kartonë të verdhë
- 4

protestë
- 5

FOTO-LAJM/ Berisha thotë 'nuk është e jona', por njerëzit e PD zbarkojnë në fakte, projekte serioze
- 5

Tërmeti tek Aruba / SMS nga Sky: Ahmetaj, ç'a thotë Derman? Ke folur...do

Kronikë

Vrasja e Endri Goxhajt në Memaliaj, pas dy muajsh në arrati Marjaldo Nela vetëdorëzohet në polici

Me vetëdorëzimin e Marjaldo Nelës, një prej personave të shpallur në kërkim pas krimit, hetimet pritet të vijojnë me marrjen në pyetje të tij për të sqaruar plotësisht rrethanat e ngjarjes.



Foto ilustruese e ngjarjes

[Sh] Redaksia
30 Qershor, 13:18 | Përditësimi: 30 Qershor, 13:27

Share Post

A A

Pas rreth dy muajsh në arrati, [Marjaldo Nela](#), i shpallur në kërkim për **vrasjen e Endri Goxhajt në Memaliaj**, është vetëdorëzuar në polici.

Pas paraqitjes së tij, ai është ndaluar dhe është vënë në dispozicion të organeve të drejtësisë për vijimin e procedurave hetimore.

Ngjarja për të cilën akuzohet ndodhi mbrëmjen e 21 prillit në qendër të Memaliajt. Sipas Prokurorisë, gjithçka nisi nga një konflikti të çastit mes 7 personave që nuk ishin pjesë e asnjë grupi rival. Në sherr më pas ndërhyjnë edhe [Dali Nela](#), vjehrri i tij Aldo Kalemi dhe persona të tjerë.



[Sh]
.com

LEXO EDHE:
Gjirokastra, ndër qytetet më të 'lakmuara' nga të huajt! Vetëm gjatë qershorit, u vizitua nga 25 mijë turistë

Në kulmin e konfliktit, [Endri Goxhaj](#) nxori një pistoletë dhe qëlloi katër herë në drejtim të Dali Nelës, duke e lënë të plagosur.

Kur panë Dali Nelën të rrëzuar në tokë, dy vëllezërit e tij, Donaldo dhe Marjaldo Nela, sipas prokurorisë, nxorën armët dhe qëlluan në drejtim të Endri Goxhajt. Si pasojë e të shtënave, 30-vjeçari humbi jetën në vend. Sipas hetuesve, pamjet filmike tregojnë se Goxhaj nuk arriti të reagoonte me armë në momentin kur u qëllua nga dy vëllezërit.

Pas të shtënave, Donaldo dhe Marjaldo Nela morën me automjetet vëllanë e tyre të plagosur dhe e transportuan me urgjencë në Spitalin e Gjirokastrës. Më pas u larguan dhe u shpallën në kërkim nga policia si autorët e dyshuar të vrasjes.

Për këtë ngjarje, Gjykata e Gjirokastrës **vendosi masën e sigurisë** "arrest shtëpie" për Dali Nelën, Aldo Kalemin dhe Ermal Matajn. Ky i fundit akuzohet për veprën penale "Veprime që pengojnë zbulimin e të vërtetës", pasi dyshohet se ka fshehur armën me të cilën është qëlluar ndaj Goxhajt.

Me vetëdorëzimin e Marjaldo Nelës, një prej personave të shpallur në kërkim pas krimit, hetimet pritet të vijojnë me marrjen në pyetje të tij për të sqaruar plotësisht rrethanat e ngjarjes. Në kërkim mbetet ende vëllai i tij, [Donaldo Nela](#).

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

U.D/Shqiptarja.com

TAG: [Gjirokaster](#) [Marjaldo Nela](#) [dali nela](#) [endri goxhaj](#) [donaldo nela](#)

Komento

Komente

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016



Sondazhi i ditës:
Sipas jush, protesta te Kuvendi a ka qenë e dhunshme nga ana e protestuesve?

Po

Jo

Nuk e di

3 Korrik, 10:41

Lajme të tjera



Një nga Ne/ Në kërkim të originalitetit! Njihuni me qendistaren nga Gjirokastra që rikrijon veshjet tradicionale: Shkon çmimi deri në 1500 euro

 [Xhensila Nako](#)

4 Korrik, 13:52



Llixhat e Bënjës/ Rama poston pamje të vizitorëve dhe aktiviteve argëtuese: Pasqyrë e punës së përkushtuar për Shqipërinë turistike

28 Qershor, 08:13



Natë festive në Llixhat e Bënjës, Rama ndan pamjet: Flamingot me qeleshe të bulevardit tentuan të krijojnë vatër të re nxitjeje, por fitoi e vërteta (VIDEO)

27 Qershor, 23:14



Llixhat e Bënjës/ Rama ndan pamjet: Sulm nga ekstremistët e protestës, janë shëmbëlltyrë zhvillimi! Luftë mes Shqipërisë në BE dhe 'Shqipëria e re' e dështakëve

27 Qershor, 10:48



FOTOT/ Rimbushen me ujë vaskat e llixhave të Bënjës, Kumbaro: Punimet ende s'kanë përfunduar, jemi në fazë testimi

26 Qershor, 13:26



Gjirokastër/ Aksident në kthesën e Viroit, mikrobuzi me turistë përplaslet me 'Audin'

23 Qershor, 17:47



'Lëre kolltukun'- Bido ironizon Muçin: S'ia vlen as zaptimi i oborrit të shkollës 'Koto Hoxhi' në Gjirokastër, as aksionet e tua si ndërtues në Arameras

22 Qershor, 20:28



Risi në kulinari, në Përmet përgatitet gliko me domate! Mjeshtreja Liri Bonjo ruan recetën me fanatizëm

 [Piro Nase](#)

21 Qershor, 17:49



Gjirokastër/ 'Kur mungon fjala', mesazh kundër dhunës në familje! Studentët për herë të parë aktorë në teatër

 [Piro Nase](#)

20 Qershor, 16:56



Mbytet një 62-vjeçar në liqenin e Viroit në Gjirokastër

19 Qershor, 19:30



Bagëtisë e ngordhura në përroin e Psarit, Shërbimi Veterinar i Gjirokastrës për Report Tv: Janë sulmuar nga ujqërit, mbetjet u grososën

19 Qershor, 13:35



Këlcyrë/ Bagëti të ngordhura në përroa, shqetësim për banorët! Veterinaria: U sulmuan nga ujqërit, s'ka rrezik për epidemi

 [Piro Nase](#)

19 Qershor, 11:16





ÇMIMI MË I MIRË
15.999
-36%
24.999

Televizor Hisense, 43"

DVB-T2 / C, HDMI, USB, VGA, CI+, MPEG4, H.264, Audio: 8+2+2+2





HOROSKOPI



× **[Sh]**
.com Lajmi i fundit



Botërori 2026 'rrëzon' një tjetër trajner, Roberto Martinez largohet nga Portugalia! Kush pritet ta zëvendësojë

7 Korrik, 00:42

RAPORTO! Chat live
me Shqiptarja.com

